Programi i ri i WUS Austria, "Rasti Sfidues i Kosovës"

"NACIONALE - 08.02.2008 Pg. 5

Leonora Shala

"KOSOVA CASE CHALLENGE"

"Rasti Sfidues i Kosovës" synon hapjen e mundësive dhe perspektivave të reja për studentët e shkëlqyer të Edukimit të Lartë të Kosovës, duke i forcuar lidhjet në mes të edukimit të lartë dhe punësimit si dhe me ofrimin e shanseve konkrete për punë

Prishtinë, 7 Shkurt

WUS Austria, në një konferencë për shtyp, prezantoi projektin "Kosova Case Challenge" apo "Rasti Sfidues i Kosovës". Gara studentore është e bazuar në Metodën e Rastit Studimor që zhvillohet në katër raste: Rasti biznesor, ku përfshihen studentët e të gjitha fushave të ekonomikut; Teknologjia informative dhe komunikuese për studentët e shkencave teknike; Modeli i këshillit të Evropës për studentët e shkencave politike, marrëdhënie ndërkombëtare, diplomaci, sociologji dhe fusha tjera të ngjashme dhe Simulimi i gjyqit për studentët e juridikut. Këtë vit do të jetë në 11 vende të Evropës Juglindore dhe në këtë rast edhe "Rasti Sfidues i Kosovës", që përfaqëson gjysmë finalen për "Ballkan Case Challenge", tha Drejtori i WUS Austria, But Dedaj, dhe shtoi se "Kosova Case Challenge 2008" është organizuar këto tri vitet e fundit dhe shtoi se "KCC 2008" do të organizohet në një dimension pak më ndryshe se herëve të kaluara. Sipas tij, "Rasti Sfidues i Kosovës" synon në hapjen e mundësive dhe perspektivave të reja për studentët e shkëlqyer të Edukimit të Lartë të Kosovës, duke i forcuar lidhjet në mes të edukimit të lartë dhe punësimit si dhe me ofrimin e shanseve konkrete për punë. "Kjo përfshinë një standard të lartë të garës dhe participantëve, një aspekt intensiv i punësimit dhe rekrutimit, sigurimin i mundësive konkrete të karrierës për participantët dhe pjesëmarrësit e viteve të kaluara, rrjetëzimi i të gjitha palëve të involvuara dhe një Evropa Juglindore dhe Austria", potencoi Dedaj.

Me këtë rast "Kosova Case Challenge", tashmë ka siguruar një stabilitet për tri vitet pasi që ka mbështetjen e Agjencionit Austriak të Kooperimit deri në 2010. Këtë vit "KCC"-ja do të përbëhet nga tri pjesë: Trajnimi për aplikues lidhur me Garën e Rastit Studimor, gara, ku fituesit nga çdo disiplinë do të selektohen për BCC-në, që do të mbahet në Vjenë dhe Ngjarja e Rekrutimit.

Dedaj tha se në Kosovë rreth 50 prezantimit, trajnimit për shkruarjen e CV-së, sjellja në intervistë si dhe trajnim për t'i përgatitur studentët në disiplinat garuese. Këta participuesë do të garojnë në këto disiplina: Stimulimi i Gjyqit, Gara e Rastit të Biznesit, Modeli i Këshillit të Evropës dhe Gara e Rastit në Teknologjinë Informative dhe Komunikuese. Kurse, kandidatët e këtij projekti duhet të jenë studentë të shkëlqyer dhe që janë në përfundim të studimeve në fushën ekonomikut, juridikut, shkencave politike, nga mbarë vendet e ticipuesitë kualifikohen me një procedurë rigoroze të selektimit duke u bazuar në performansën e tyre akademike, aktivitetet jashtë mësimore si dhe të jetë i rrjedhshëm në gjuhën angleze dhe gjermane. Afati i aplikimit ka filluar më 18 janar dhe do të zgjasë deri më 31 mars, kurse të drejtë konkurrimi kanë të gjithë studentët e UP-së dhe Universiteteve private në Kosovë, por që janë të licencuar nga MASHT-i. Në mënyrë që të forcohen lidhjet në mes të edukimit të lartë dhe punësimit, dyfishta do të prezantohen Panairi i Punës në BCC Vjena dhe Ngjarjet e Rekrutimit në gjysmë finale. Me anë të këtij programi, WUS Austria, ofron mundësi kompanive, institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare që të bëhen partnere në mënyra të ndryshme, mbështetje financiare, mënyra tjera, praktikë, trajnime, libra, bursa, hapësirë për implementimin e garës, produkte etj. "Rasti

Projekti

WUS Austria implementon programe mbështetëse në Evropën Juglindore që nga viti 1994 duke u fokusuar në universitete dhe komunitet akademike. Kurse në Kosovë operon që nga viti 1998.